

PREVENTIVI PËRMBLEDHËS I PUNIMEVE
Objekti :Rehabilitimi (i Pjesshëm) i rrjetit Ujitës të Fushës Hekal- Rromes
(KANALI KRYESOR DHE STACIONI I POMPIMIT)

Nr.	Nr. An	ZERAT E PUNES	Njësi	Sasia	Cmimi për njësi	Vlefte
1	2	3	4	5	6	7
1	3-2+3-7	Prerje bime e shkulje rrenjesh pergjate trases se kanalit	m2	9445		
2	3-3	Prerje e sistemim peme fi > 10 cm	cope	362		
3	3-25/a + 3-101/a	Germim dheu per pastrim e per riseksionim te kanalit, 40% me makineri	m3	9740		
4	3-47/1c	Mbushje hedhje e ngjeshje me dhë ne kanal	m3	1679		
5	3-239	Beton i varfer M 100 , t= 4-6 cm si nenshtrese	m3	761		
6	3-243/1	Beton M-200 per veshje t = 8 -9 cm	m3	1354.3		
7	3-243	Beton M-200 per riparime te veshjeve e te veprave ekzsituese dhe rakordimet e nevojshme me kanalim.	m3	47.8		
8	3-287	Hekur betoni Fi 6-8 mm per perforcimin e veshjeve	ton	64.21		
9	An 10	Ndertim mur mbajtes betoni M 200 TIP 1 (analize 1 ml)	ml	74		
10	An 10/a	Ndertim mur mbajtes M 200 TIP 1-a (analize 1 ml)	ml	26		
11	An 10/b	Ndertim mur mbajtes M 200 TIP 2-a (analize 1 ml)	ml	42		
12	An 9	Kalim i zones se perroit pik 7-7a , L = 10 m (analize)	cope	1		
13	An 1	Ndertim Ure auto HD = 1.2 m, H=1m, L = 5 m	cope	2		
14	An 1/a	Ndertim Ure auto HD = 1.2 m, H=1m, L = 7 m	cope	1		
15	An 2	Ndertim Ure auto HD = 1.0 m, H=0.8m, L = 5 m	cope	6		
16	An 2/b	Ndertim Ure auto HD = 1.0 m, H=0.8m, L = 7 m	cope	3		
17	An 2/a	Ndertim Ure auto HD = 1.0 m, H=0.8m, L = 4 m	cope	1		
18	An 3	Ndertim Ure auto HD = 0.8 m, H=0.7m, L = 5 m	cope	3		
19	An 4	Ndertim Ure kembesore Hd = 4m, L= 1m	cope	4		
20	An 5	Prize me tub betoni fi = 40, L= 3 m	cope	14		
21	An 6	Prize e thjeshte 40x50 cm	cope	3		
22	An 6/a	Shkarkues anesor i thjeshte tip prize 40x80 cm	cope	2		
23	An 7	Shkarkues me pusete e nenkalim me tuba Fi 100 cm	cope	3		
24	An 8	Barazh me porte metalike 100x100cm	cope	2		
25	An 8/a	Barazh me porte metalike 80x100cm	cope	1		
26	An 11	Ndertim i prizes me tuba celiku Fi 325/5.6 mm, L = 14 ml	cope	1		
27	An 12	Riparimi i prizes me tuba celiku Fi 300 mm pik 94	cope	1		
28	An 13	Riparimi e mbilartesis deri ne 0,2 m i kalimeve ekzsituese me lugje b/arne (analize per 1 ml)	ml	41		
29	An 14	Prishje e shkulje vepra ekzsituese te demtuara (analize)	cope	12		
30	2-37/1a	Transport materiali me auto deri 1 km	m3	1358.6		
31	An 15	Punime riparimi e ndertim montimi ne stacionin e pompimit (shih analizat e veçanta)	cope	1		
32	An 16	Punime elektromekanike	cope	1		
		Shuma				
		Fond rezerve 5 %				
		Shuma				
		TVSH 20 % (per punime ndertim montim)				
		Shuma ndertim montim				
	An 17	Vlera per makineri e paisje				
		Shuma Totale e Vepres				

Shenime:

Gjate zbatimit te punimeve per realizimin e ketij projekti, pervec te tjerash duhen mbajtur parasysh edhe sa me poshte:

Cmimet e zerave te punimeve jane bazuar sipas Portalit "Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat

e Punimeve në Ndërtim".

1. Punimet për rehabilitimin e kanalit kryesor u jites parashikojnë të gjitha punimet për pastrimin e kanalit nga aluvionet, nga shkarjet apo mbushje të tjera si dhe veshjen me beton M 200 sipas seksionit TIP në të gjithë gjatësinë e kanalit ose riparimin me beton **M 200** të zonave pjesërisht me veshje ekzistuese të rregullt ose pjesërisht të demtuar. *(Zonat saktësohen pas punimeve të germimit)*
Gjithashtu projekti ka parashikuar ndërtimin e veprave të reja *(atje ku ato janë të nevojshme)* ose kryerjen e riparimeve të nevojshme të veprave të artit ekzistuese përfshi edhe vendosjen e portave metalike në prizat apo barazhet e riparuar.

2. Volumet e punimeve të dherave, të veshjes me beton apo ato për riparimin e veshjeve apo të veprave të artit dhe ndërtimin e mureve mbajtës janë bazuar në vlerësimin e gjendjes faktike dhe të matjeve të nevojshme topografike që janë kryer gjatë viteve 2017-2018, e për rrjedhojë, me kalimin e kohës mund të ketë ndryshime të situatës. Prandaj, në çdo rast, për të bërë saktësimin e vëllimeve, para fillimit të punimeve për realizimin e projektit duhet të bëhen azhurnimet e nevojshme të gjendjes faktike të kanalit dhe të veprave. Diferencat e punimeve vlerësohen e konfirmohen paraprakisht nga supervizioni dhe pas miratimit të tyre nga punëdhënësi, duhet të përballohen nga fondi rezervë.

3. Në këtë preventiv, llogaritjet e vëllimit të betonit për veshjen e kanalit kryesor janë bërë duke mbajtur parasysh që për riveshjen e faqeve anësore të kanalit në 40 % të gjatësisë së tij të shfrytëzohen, si nënshtresë, veshjet anësore ekzistuese (me pllaka ose betone) kurse për veshjen e bazës (tabanit) të kanalit të shfrytëzohet vetëm 20% e veshjes ekzistuese. Në këtë vëllim është mbajtur parasysh edhe shtesa e veshjes me beton të kanalit në rastet kur ruhet seksioni ekzistues i kanalit me gjerësi më të madhe se ajo e llogaritur në projekt. Në çdo rast seksioni i ri i kanalit do të realizohet sipas detajeve të seksionit TIP të dhënë në fletët e vecanta të projektit.

4. Rehabilitimi i kanalit do të bëhet duke respektuar kuotat e projektit dhe gjithë elementet e tjera hidraulik të kanalit siç jepen në rubrikën e posaçme në vizatimin e profilin gjatësor të tij. Këto kuota do të mbahen parasysh edhe në zonat ku do të ketë rivishje me beton.

5. Në ofertën e çmimit për zërat... "**Punime dhe për germim...**" ose "...**Mbushje me dhe...**" duhet të përfshihen të gjitha proceset e punës për realizimin e seksionit të kanalit sipas seksionit tip të dhënë në projekt, ku **përfshihen, por nuk kufizohen:**

germimi i kanalit e rrafshimi i skarpave në të gjithë lartësinë e shtrirjes së tyre (sipas profilave tërthor) sistemimi e sheshimi i dherave të germuara dhe atyre ekzistuese, përfshi transporti i tyre (po që nevojë), formimi i bankinës së kanalit (sipas dimensionit të dhënë në seksionin tërthor tip), thyerja e betoneve e pastrimi i kanalit dhe i veprave të artit nga llumrat dhe mbeturina të tjera, etj. Aty përfshihet edhe skarifikimi i zonave të kanalit që do të mbushen dhe i zonave ku do të merret dheu, për mbushje, realizimi i mbushje-ngjeshje, për formimin e trupit të kanalit, prerja dhe sistemimi i dherave pas mbushjes etj..

5-a. Në vëllimin e punimeve të germimit janë përfshirë edhe vëllimet për skarifikimin e zonave ku do të bëhet mbushje dhe germimi i nevojshëm për vendosjen e shtresës së betonit për veshje.

6. Në llogaritjen e vëllimit të transportit të materialeve me kafshë është mbajtur parasysh vetëm 10 % e vëllimit të materialeve.

7. Numri dhe pozicionimi, brenda sistemit, i prizave të reja apo atyre që do të riparohen do të saktësohet në bashkëpunim me punëdhënësin pas realizimit të punimeve të dheut dhe rivlerësimit të gjendjes reale të prizave dhe portave.

8. Si rezultat i zhvillimeve urbane të zonës me intensitet relativisht të lartë, gjatë trasës së kanalit u jites, mund të ketë mosperputhje të faktit me detaje të ndryshme, apo me pozicionin e veprave të artit të dhëna në projekt apo preventiv, prandaj para fillimit të punimeve nga firma ndërtuese, duhet të bëhen azhurnimet e nevojshme dhe në bashkëpunim me supervizionin dhe punëdhënësin, të bëhet rivlerësimi i gjendjes.

8.a. Spostimi i pozicionit të ndërtimit të veprave të artit mund të propozohet për ndryshim nga pushteti lokal ose OPU-ja (Organizata apo Shoqata e Përdorimit të Ujit) për zbatimin e tyre bëhet pas miratimit nga supervizioni dhe nga punëdhënësi.